

FJALA E DEPUTETES MIRELA KUMBARO

E HËNË 3 TETOR 2022

Nuk ka gjirokastrit që s’do ta vinte buzën në gaz, duke dëgjuar, siç thonë gjirokastritët, broçkulla nga kjo foltore, sikundër na ndodh të dëgjojmë herë pas here. Të flasësh për Gjirokastrën e të thuash broçkulla, është të gajasësh gjithë Qafën e Pazarit e të gjitha hotelet e Gjirokastrës që deri në vitin 2013 nuk i kishit parë as në ëndrrat më të bukura, sepse e kishit kthyer Gjirokastrën në një ëndërr të keqe. Deri në vitin 2013 Gjirokastra kishte një hotel e gjysmë dhe asnjë restorant ku mund të haje.

Shkoni sot në Gjirokastër, sepse keni kushedi sa kohë pa shkelur atje, ose e shkelni duke e shijuar pa treguar. Hyni sot në “Booking.com” për të parë se sa oferta akomoduese, sa hotele, sa struktura bujtëse, sa bujtina, sa restorante, sa lokale ka. Qafa e Pazarit sot dhe qendra historike nuk kanë lidhje me atë që latë ju në vitin 2013. Në fakt, kjo tregoi se çfarë vitaliteti kanë gjirokastritët: që, kur u jep mundësinë, kur investon, kur jep një model zhvillimi, ata e marrin dhe e bëjnë flamur të modelit të zhvillimit të turizmit në Shqipëri. Në fakt, sot Gjirokastra është një model shumë i bukur i asaj që është Shqipëria në turizëm. Sot Gjirokastra nuk është vetëm qyteti.

Sot Gjirokastra është qarku, është një hartë turistike e tillë, që pa frikë të duhen dhjetë ditë për të bërë shumë gjëra, madje nuk të dalin. Gjirokastra, Përmeti, por edhe Tepelena, që e përmendët, ka sot një nga hotelet model tek Uji i Ftohtë. Gjirokastra, nga kalaja e deri në hyrje, vetëm gjatë muajit gusht e ka rritur me mbi 35%, në krahasim me vitin e kaluar, që ishte tashmë një vit suksesi. Sot që flasim, Gjirokastra është e mbushur plot e përplot me turistë. Sot që flasim, Gjirokastra është absolutisht një tërheqje e investimeve jo vetëm për gjirokastritët atje, po edhe për shumë gjirokastritë të tjerë që kanë emigruar, të cilët rikthehen të investojnë.

Po si mund të keni dashuri për Gjirokastrën dhe ta nxini atë model turizmi që kemi sot? Po si mund t’jua nxërë goja dhe të flisni për Gjirokastrën me një mllef të tillë që jo një gjirokastrit nuk do ta kishte bërë, por nuk do ta kishte bërë asnjë shqiptar?! Megjithatë, Gjirokastra vazhdon të

jetë një atraksion, vazhdon të jetë vendi që me shumë kënaqësi shoh se deputetë e jo deputetë, gjirokastritë dhe jo gjirokastrite e preferojnë për shëtitje, për të kaluar fundjavat, për të ftuar miq dhe për t'u krenuar. Tekefundit, kjo ka rëndësi. Në fakt, të gjithë ata turistë, që e vizituan Shqipërinë, të paktën deri më 30 gusht, sepse Shqipëria ka Gjirokastrër, Shkodër, Korçë, Durrës, Vlorë, Sarandë, pra vetëm deri më 30 gusht kemi kaluar shifrën e turistëve që na vizituan tërë vitin 2021.

Në tërë vitin 2021 Shqipërinë e vizituan mbi 5,6 milionë vizitorë, numër të cilin ne e kemi kaluar deri më 30 gusht. Si i thonë asaj fjalës: “Qentë le të lehin, karvani le të ecë përpara”, prandaj edhe Gjirokastra vetëm përpara do të ecë.